



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL  
AUTORITETI KOMBËTAR I USHQIMIT  
DREJTORIA E SHËRBIMEVE TË BRENDSHME  
SEKTORI I BURIMEVE NJERËZORE DHE ARKIV-PROTOKOLLIT

Nr. 5507/Prot.,  
3

Tiranë, më 07.11. 2024

SHPALLJE  
TË LISTËS SË KANDIDATËVE TË KUALIFIKUAR  
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E AUTORITETIT KOMBËTAR TË USHQIMIT

Në mbështetje të ligjit nr.7961 datë 12.07.1995 “Kodi i Punës në RSH”, i ndryshuar, neni 19, pika 1 të ligjit nr.44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative në RSH”, të ligjit nr.90/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”, i ndryshuar, të Rregullores së Brendshme për organizimin dhe Funksionimin e Autoritetit Kombëtar të Ushqimit, të miratuar me Urdhrin nr.297 datë 23.6.2022. të Ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Ligjit nr. Nr.9863, datë 28.1.2008 “Për Ushqimin”, i ndryshuar, në VKM-në nr. 708 datë 9.9.2020 “Për organizimin dhe funksionimin e Autoritetit Kombëtar të Ushqimit”, Ligjit nr. 10433 datë 16.6.2011 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, Urdhrit të Kryeministrit nr. 128, datë 26.10.2020 “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Autoritetit Kombëtar të Ushqimit”, Manualit të Rekrutimit (i ndryshuar),

**Autoriteti Kombëtar i Ushqimit**, në përfundim të procesit të verifikimit dhe vlerësimit të dokumentacioneve të dorëzuara nga kandidatët për 1 (një) pozicion të lirë pune të shpallur në Drejtorinë e Përgjithshme të AKU-së, në pozicionin:

- “1 (një) pozicion të lirë pune **“Specialist”** në Sektorin e Ankesave Administrative dhe Gjyqësore në Drejtorinë e Përgjithshme të AKU-së.

**N J O F T O N:**

1. Lista e kandidatëve të kualifikuar për të vazhduar fazën e dytë të konkurrimit është si vijon:

1. Z. Alket Mersini

2. Intervista do të zhvillohet **më datë 8.11.2024, ora 10:00**, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të AKU, adresa Bulevardi “Zogu i I-rë”, Njësia Administrative Nr. 9, Tiranë.

3. Kandidatët do të intervistohet në lidhje me:

*-Njohuri të përgjithshme për Kodin e Procedurës Administrative;*

*-Njohuri mbi Ligjin Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”;*

*-Njohuri mbi Ligjin Nr. 8730, datë 18.1.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e Shërbimit të Përmbartimit Gjyqësor”;*

*-Njohuri mbi VKM-në nr.708, datë 9.9.2020 “Për organizimin dhe funksionimin e Autoritetit Kombëtar të Ushqimit”.*

4. Totali i pikëve të vlerësimit të kandidatit është 100, të cilat ndahen përkatësisht:

-50 pikë për jetëshkrimin/eksperiencën/pastërtinë e figurës

-50 pikë për intervistën me gojë.

**DREJTOR I PËRGJITHSHËM  
EDMOND RRUSHI**

